



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

07.07.2022

Drejtuar: "Ada-Co" SHPK, me adresë sipas QKB-së "Pogradec Zona Industriale", me numër NIPT: K64112603J, perfaqesuar nga administratori znj.Selvi Latifllari.

Procedura e prokurimit/lotit: "**Procedurë e hapur-pune-elektronike**"

Numri i procedurës/referenca e Lotit: **REF-31561-06-02-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]: "**Mirembajtje ndertesash**".

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Buletini Nr. 72 datë 6 Qershor 2022]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "Infinit" SHPK

J74304623M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **15.238.954,55** (pesembedhete milion e dyqind e tridhete e tete mije e nenteqind e pesedhete e kater presje pesedhete e pese) **leke pa TVSH.**

2. "Ada-Co" SHPK

K64112603J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **14.473.356,63** (katermbedhete milion e katerqind e shtatedhete e tre mije e treqind e pesedhete e gjashte presje gjashtedhete e tre) **leke pa TVSH.**

3. "Rej" SHPK

J93711608Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **15.584.859,26** (pesembedhete milion e peseqind e tetedhete e kater mije e teteqind e pesedhete e nente presje njezet e gjashte) **leke pa TVSH.**

4. "Ina" SHPK

J61814009W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **11,193,055** (njembedhjetë milion e njëqind e nentëdhjetë e tre mijë e pesëdhjetë e pese) **leke pa TVSH.**

5. "Gerard-A" SHPK

L12407005L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **13,750,500** (trembedhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind) **leke pa TVSH**

6. "Valona Konstruksion" shpk

K26330202E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **16.821.389,12** (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e një mijë e treqind e tetëdhjetë e nente presje dymbëdhjetë) **leke pa TVSH.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "Ina" SHPK

J61814009W

Vlera: **11,193,055** (njembedhjetë milion e njëqind e nentëdhjetë e tre mijë e pesëdhjetë e pese) **leke pa TVSH.**

Nga krahasimi dhe formula e përdorur, si dhe nga SPE rezulton se oferta ekonomike e vlefshme është **anomalisht e ulët**. Pra nga perlllogaritjet rezulton se oferta e shoqërisë "INA" shpk të jetë ulur me shumë se 25% e fondit limit dhe praktikisht të jetë oferte anomalisht e ulët. Atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantët të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së. Per kete qellimi i eshte derguar njoftim shoqërisë "INA" shpk nga sistemi elektronik ne adresen ne dt.29.06.2022.Mbeshtetur ne nenin 93 te LPP,shoqërisë i eshte lene nje afat tre ditor pune ,per te kthyer pergjigje.Keshtu me date 04/07/2022 ka mberritur pergjigja ne SPE nga operatori "INA" shpk me lende: "Kthim pergjigje per "Oferte anomalisht te ulët".

KVO ka vendosur ta refuzojë ofertën e paraqitur nga "INA" shpk sepse edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "INA" shpk në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Akoma edhe më tej, referuar shkresës datë 04.07.2022 "Kthim pergjigje per oferte anomalisht e ulët" së paraqitur nga operatori "INA" shpk rezulton te jete deklaruar se: "...ketu mund te

permendim gjendjen e materialeve te domosdoshme ne magazinat tona, si materiale, cemento, gure, rere, granil, stabilizant, material hidraulike, elektrike etj...

OE ka paraqitur fatura tatimore për të vërtetuar këtë fakt., nga ku rezulton se:

KVO vëren se "INA" shpk, përveç argumentimit të vet në formën e një preventivi vetdeklarativ (analize cmimesh), ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës sikurse kërkuar (fatura tatimore shitje), nga ku rezulton se:

OE ka paraqitur fature tatimore shitje date 13.04.2020 nga ku rezulton se cmimi i Granilit per m3 eshte 600 leke pa TVSH, nderkohe qe ne analizen teknike te paraqitur nga OE cmimi i granilit eshte 700 leke, ka nje mosperputhje te cmimeve te cmimit te deklaruar me fature dhe llogaritjes ne analizen e cmimeve.

OE ka paraqitur fature tatimore shitje date 07.05.2018 nga ku rezulton boje hidromat me cmim 14 litra 1046.66 ose 1 liter boje hidromat=74.76 leke nderkohe qe ne analizen teknike te cmimeve e ka vendosur cmimin e bojes 100 leke, ka nje mosperputhje te cmimeve te cmimit te deklaruar me fature dhe llogaritjes ne analizen e cmimeve.

OE ne analizen teknike ne zerin 2.352 ka perlllogaritur cimenton eshte perlllogaritur me cmimin 8.1 leke per kg nderkohe qe ne faturen nr.89/2022 te paraqitur cmimi per 1 kg cemento eshte 0.8917 leke, ka nje mosperputhje te cmimeve te cmimit te deklaruar me fature dhe llogaritjes ne analizen e cmimeve.

Analiza e cmimeve e cila eshte kërkuar nga autoriteti kontraktor, eshte kerkuar pikërisht për krijimin e bindjes për realizmin me sukses të kontratës edhe me vlerën e ofertuar e cila rezulton anomalisht e ulët. Me anë të dokumentacionit të paraqitur operatori nuk ka mundur të krijojë bindjen tek KVO lidhur me këtë fakt, per arsyet me poshte:

1. Analizat e paraqitura nga ana juaj për të gjitha zërat e punimeve kanë mangësi sepse në analizë ku thote shpenzime plotesuese (Shp pl) 8% dhe fitimi 10% ju nuk i keni llogaritur me kete formule por me një përqindje tjetër të cilën ju nuk e keni vendosur sakte, por keni vendosur 10% fitim per te gjithë zerat.
2. Bashkëngjitur këtij procesverbali po vendosim analizën e hartuar nga ana juaj dhe korigjimi i bërë nga ana jonë. Me ngjyrë të verdhë kemi shenuar cmimin e dale nga analiza e operatorit ekonomik dhe me jeshile çmimi real sipas llogaritjes sipas VKM Nr.629, datë 15.07.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".
3. Operatori ekonomik ne analizen e paraqitur ka ndryshuar oret e punes te specialisteve dhe punetoreve te cilat jane te perlllogaritura sipas VKM Nr.629, datë 15.07.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".
4. Nga verifikimi i analizës rezulton se per te njejtin ze konkretisht: me nr.2.262 An. Shtrese Betoni C6/10 ka ndryshuar oret e punetoreve, njehere e ka vendosur 8 ore nga 8.6 qe parashikon VKM Nr.629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" dhe po te njejtin ze e ka perlllogaritur 10.7 ore pune nga 8.6 ore qe parashikon VKM Nr.629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

5. Sa i perket nr.2.276 an Shtrese parketi OE nuk i eshte permbajtur VKM Nr.629, datë 15.07.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", pasi ka hequr binare pishe dhe gozhde dhe ka shtuar shtrese hidroizoluese dhe material ngjites, duke mos iu permbajtur keshtu VKM Nr.629, datë 15.07.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon se nga ana e operatorit ekonomik "INA" shpk – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i sakte që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: *metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), **duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.**

Per sa me siper, oferta e "INA" shpk skualifikohet sepse **kjo ofertë nuk është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.**

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e "INA" shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

2. "Infinit" SHPK, me oferte ekonomike **15.238.954,55** (pesëmbëdhjete milion e dyqind e tridhjetë e tete mije e nentëqind e pesëdhjete e kater presje pesëdhjete e pese) **leke pa TVSH.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1.OE "Infinit" shpk ka paraqitur formularin e vetedeklarimit sipas shtojces 8 te pa firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqerise, qe sjell pavlefshmerine e formularit te vetedeklarimit duke mos plotesuar kriteret e pergjithshme dhe ato teknike per kualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e "INFINIT" shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

3. **"REJ" shpk** me oferte ekonomike me vlere **15.584.859,26** (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nente presje njezet e gjashtë) **leke pa TVSH.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1.Operatori ekonomik ka paraqitur ISO 9001:2015 e cila ka skaduar në datë 15.11.2021, certifikata nuk është vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit sic kërkohe në pikën 2.3.4 të kriterëve të kapacitetit teknik.

2.Operatori ekonomik ka vetedeklaruar disponimin e 1 (nje) kamioncine me targe PG5886B ndërkohe që në DT në pikën 2.3.5 kërkohe 2 Kamioncina me kapacitet mbajtes deri 3 ton.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE **"REJ" shpk** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

4. **"Gerard-A" shpk** me oferte ekonomike **13,750,500** (trembëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind) **leke pa TVSH.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.
- Operatori ekonomik "Gerard-A" shpk nuk ka paraqitur Formularin Permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës nr 8.
- Operatori ekonomik "Gerard-A" shpk nuk ka paraqitur sigurim oferte ekonomike të kërkuar në DT.
- Operatori ekonomik "Gerard -A" shpk ka paraqitur formular oferte të pa firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë.
- Operatori ekonomik "Gerard-A" shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për punë të ngjashme për të përmbushur pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik.
- Operatori ekonomik "Gerard-A" shpk nuk ka vetedeklaruar asnjë nga mjetet dhe punonjësit e kërkuar në pikën 2.3.3/1, 2.3.3/2, 2.3.3/3, 2.3.3/4 dhe pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE “**Gerard-A**” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme**.

5. **"VALONA KONSTRUKSION" shpk** me oferte ekonomike **16.821.389,12** (gjashtembdhjete milion e teteqind e njetzet e nje mije e treqind e tetedhjetë e nente presje dymbdhjete) **leke pa TVSH**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1.Operatori ekonomik “**VALONA KONSTRUKSION**” shpk ka paraqitur formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8, te paplotesuar ne shume seksione duke mos deklaruar se:

- Personi/personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:etj.nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.
- Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjisllacionin mjedisor, social dhe të punës.
- Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituruar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

2. Operatori ekonomik ka vetedeklaruar disponimin e 1 (nje) kamioncine me targa AA571CP nderkohe qe ne DT ne piken 2.3.5 kerkohen 2 Kamioncina me kapacitet mbajtes deri 3 ton.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE “**VALONA KONSTRUKSION**” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar *si ofertë të pavlefshme.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "**Ada-Co**" SHPK, me adresë sipas QKB-së "Pogradec Zona Industriale", me numër NIPT: K64112603J, perfaqesuar nga administratori znj. Selvi Latifllari, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **14.473.356,63** (katermbdhjete milion e katerqind e shtatedhjete e tre mije e treqind e pesedhjete e gjashte presje gjashtedhjete e tre) **leke pa TVSH**, është identifikuar si Oferta e suksesshme per "**Mirembajtje ndertesash**".

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Enton BERBERI